



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Në bazë të nenit 5, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (**Ligji i AKP-së**), dhe kapitullit 3, të Politikave Operative të AKP-së, Agjencia Kosovare e Privatizimit ("**AKP**") si administratore me mirëbesim, përcakton statusin e ndërmarrjeve dhe asetëve të saj në territorin e Kosovës, në bazë të dokumentacionit dhe dëshmive në dispozicion. Lidhur me këtë, me datë 21 shkurt, 2019 shpallë këtë:

NJOFTIM

Në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së nr. Ref. BD-108/18, të datës 31/10/2018.

Asetet e ndërmarrjes "SOLID" Suboticë, KPS1516/PRN194, që gjenden në territorin e Kosovës janë pronë shoqërore dhe bien nën kompetencat administrative të Agjencisë.

Ndërmarrja "QENDRA E REKREACIONIT PËR FËMIJË DHE TË RINJË- PISHAT E DEÇANIT" DEÇAN, KPS0270/PEJ166, është pronë shoqërore dhe bie nën kompetencat administrative të Agjencisë.

Ndërmarrja "BASHKËSIA E SIGURIMIT TË PASURISË DHE PERSONAVE" (KOSOVA) PRISHTINË, KPS1512U/PRN183, është pronë shoqërore dhe bie nën kompetencat administrative të Agjencisë.

Në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së nr. Ref. BD-112/9, të datës 30/01/2019.

Ndërmarrja Shoqërore KB "STUDENQANI" në Studenqan, KPS1521/PRZ094, është pronë shoqërore dhe bie nën kompetencat administrative të Agjencisë.

Në bazë të Vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së nr. Ref. BD-112/9, të datës 30/01/2019:

Asetet e ndërmarrjes "BANKA E VOJVODINËS" Novi Sad, KPS1520/PRN195, që gjenden në territorin e Kosovës, janë pronë shoqërore dhe bien nën kompetencat administrative të Agjencisë;

Asetet e ndërmarrjes “VIJAK” Brnjak/Zubin Potok, KPS796/MIT056, që gjenden në territorin e Kosovës, janë pronë shoqërore dhe bien nën kompetencat administrative të Agjencisë;

Ndërmarrja “SERBIJA-SHUME” Shtërpcë, KPS1133/GJI052, nuk është Ndërmarrje në pronësi shoqërore dhe nuk bie në kompetencat e Agjencisë.

Shënim i rëndësishëm:

Agjencia pas përcaktimit të statusit të ndërmarrjes, e cila bie nën kompetencën administrative të saj fillon me procesin e likuidimit/shitjen e ndërmarrjes dhe asetëve të saj, pas të cilit proces në mes tjerash realizohen edhe pagesat nga mjetet financiare nga shitja e tyre për “Kreditorët” dhe “punëtorët e kualifikuar” deri në shumë në të cilën të njëjtit kanë të drejtë.

Palët e interesuara pas shpalljes së këtij njoftimi në afat prej 30 ditësh mund të ushtrojnë ankesë kundër vendimit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, në Prishtinë për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ligji përkatës i AKP-së gjendet në faqen e internetit të AKP-së <http://www.pak-ks.org> apo drejtpërdrejtë në <http://www.assembly-kosova.org/>.